

VENDIM
Nr. 529, datë 1.8.2012

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT, TË DISA MJEDISEVE TË NDËRTESES SË PREFEKTURËS ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të disa mjediseve të ndërtesës së prefekturës Elbasan, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet prefekti i qarkut të Elbasanit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha